


Aksidentet Rrugore*

Mars 2026

Në muajin mars 2026 janë regjistruar 89 aksidente rrugore, në të cilat 117 persona kanë mbetur të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur).

Gjatë periudhës janar-mars 2026, numri i aksidenteve rrugore është ulur me 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

FIG. 1 AKSIDENTET RRUGORE DHE TË AKSIDENTUARIT (TË VRARË E TË PLAGOSUR), MARS 2022 – MARS 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Gjatë muajit mars 2026, 86,5 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve.

* Të dhënat e publikuara janë paraprake dhe subjekt përditësimi.

Grupmosha 25-34 vjeç paraqet numrin më të lartë të aksidenteve, duke përbërë 32,6 % të numrit total të aksidenteve të regjistruara në këtë periudhë.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore, sipas ditëve të javës, është shënuar ditën e enjte me 18,0 %, ndërsa numri më i ulët është regjistruar ditën e dielë me 9,0 %.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore është regjistruar përgjatë harkut kohor 17:00-19:00, duke përbërë 23,6 % të numrit total të aksidenteve rrugore.

TAB.1 AKSIDENTET RRUGORE, NUMRI I TË VDEKURVE DHE TË PLAGOSURVE, SIPAS QARQEVE

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Mars 2025	Mars 2026	Mars 2025	Mars 2026	Janar-Mars 2025	Janar-Mars 2026	Janar-Mars 2025	Janar-Mars 2026
Shqipëria	88	89	128	117	301	282	424	391
Berat	4	1	4	1	8	2	8	2
Dibër	4	2	8	2	6	3	15	5
Durrës	5	1	7	1	22	19	30	29
Elbasan	1	2	3	2	14	10	19	13
Fier	10	7	19	13	28	11	44	18
Gjirokastrë	7	1	7	1	19	9	29	17
Korçë	6	6	7	6	29	18	35	18
Kukës	1	2	1	2	7	14	7	21
Lezhë	7	9	16	17	32	34	56	68
Shkodër	6	7	10	7	25	15	35	18
Tiranë	32	42	41	48	93	122	123	143
Vlorë	5	9	5	17	18	25	23	39

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it, në seksionin: [Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjetet Rrugore](#)

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore, si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrin e personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore, të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni që i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme, ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla, që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private, në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, dhe që rezulton në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person që ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve.

I plagosur: Çdo person që, si rezultat i një aksidenti, nuk është vrarë menjëherë ose nuk ka vdekur brenda 30 ditëve, por ka pësuar një dëmtim për të cilin ka lindur nevoja për trajtim mjekësor, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: frenim i papritur, mosrespektim i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektim i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Brendshme / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi.

Për më shumë informacion, referojuni te Politika e Revizionimit Statistikor.: Politika e Revizionimit Statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 - Vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

Pa vlerë

(...) - Mungesë të dhënash